VENDIM
Nr.969, datë 30.9.2009

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR MBAJTJEN E KONTABILITETIT DHE HARTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE, NGA MIKRONDËRMARRJET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1 të nenit 4 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mikrondërmarrjet me statusin e personit fizik, që në vitin e fundit financiar realizojnë një qarkullim vjetor deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë në vitin e fundit financiar, do të mbajnë kontabilitetin e thjeshtuar, me regjistrim të njëfishtë, në baza monetare.
2. Të gjitha mikrondërmarrjet e tjera, pavarësisht nga forma juridike, të cilat nuk përfshihen në pikën 1 të këtij vendimi, do ta mbajnë kontabilitetin sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
3. Mikrondërmarrjet, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, nuk janë të detyruara të zbatojnë standardet kombëtare të kontabilitetit.
4. Ngarkohet Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha